



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E VITISË
OPSTINE VITINA
THE MUNICIPALITY OF VITI

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA	
Numar - Prilajene Më/Dana	10-11-2020
Organit Org.broj	Shitje/Bl Prilag
Numri/Droj	Vlera Vendosje
02-016/01-1193	

Në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale nr. 06/L-092, Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës komunale të Qeverisë së Kosovës, Vendimit të Kuvendit Komunal të Vitisë Nr. 01-110/05-748 të datës 30.07.2020 për Inicimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në qytetin e Vitisë, Komuna e Vitisë me datën 09.11.2020 shpall:

NJOFTIM PUBLIK

Përmes

ANKANDIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS KOMUNALE ME DESTINIM TREGU I KAFSHËVE Nr.2/2020

NJOFTOHEN, të gjithë të interesuarit- personat juridik se Komuna e Vitisë, përmes procedurës së rregullt të ankandit publik me aprovimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Vitisë, do të jap në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh me mundësi vazhdimi, me destinim për **Treg të kafshëve**.

NENI I : EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Komuna e Vitisë
Adresa : Rr 28 Nëntori, 61000 Viti
Personi kontaktus: Xhelal Shaqiri
E-majli: Xhelal.Shaqiri1@rks-gov.net
Telefoni :044150413

NENI II: LËNDA E SHITJES-ANKANDIT

Autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënie në shfrytëzim 5 vjeçar me mundësi vazhdimi të pronës komunale, në fshatin Drobesh, me destinim për **treg të kafshëve**, parcela kadastrale 470-0, në fshatin **Drobesh** të Komunës së Vitisë, me sipërfaqe prej **4740 m2** në zonën kadastrale Drobesh.

NENI III: INFORMATAT ADMINISTRATIVE

I: Kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje në ankand- dokumentet e kërkuara:

1. Deklarata nën betim e Operatorit ekonomik të nënshkruar dhe vulosur, se përmbush kushtet e përshtatshmërisë
2. Çertifikatën e rexhistrimit të biznesit -kopje
3. Çertifikatën e numrit fiskal –kopje
5. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së - **Vërtetimi i ATK-së** (vetëm për fituesin).
6. Dëshmi nga Gjykata ekonomike se nuk është i dënuar – **Vërtetimi i Gjykatës Ekonomike** (vetëm për fituesin).

II: Kriteret që kërkohen për fituesin janë: Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lartë:

- Çmimi fillestar (minimal) i ofruar për muaj është 200.00 €.
- Operatori Ekonomik duhet operoj sipas çmimoreve të shërbimeve të tregut të përcaktuar nga Komisioni i Ankandit të datës 30.10.2020, si dhe mban përgjegjësi për pastrimin, mirëmbajtjen dhe renovimin e tregut gjatë periudhës së shfrytëzimit.
- Tërheqja e ofertave mund të bëhet në formë fizike dhe elektronike nga data 09.11.2020 Afati i fundit për tërheqjen e formularit të ofertave është deri me **20.11.2020**, Rr. 28 Nëntori, Zyra e prokurimit kati i 2, nr.24 të, Komuna e Vitisë.
- Afati i dorëzimit të ofertave në zarfa të mbyllur të protokoluara (një origjinal dhe një kopje) me **24/11/2020** deri në ora **13.30**, Zyra e prokurimit, Komuna e Vitisë.
- Hapja e ofertave bëhet me **24.11.2020** në ora **14.00** në Zyren e prokurimit, nr.24.
- Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e ben komisioni i emëruar i Kuvendit të komunes të Vitisë në prani të përfaqësuesve të interesuar të kompanive që kanë ofertuar
- Operatorët ekonomik të paknaqur me procesin e vlerësimit kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve në Komisionin Komunal për ankesa për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale i themeluar nga Kuvendi Komunal

Ky njoftim shpallet në shpalljet e komunës, në mjetet lokale të informimit publik dhe në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Kryesuesi i Komisionit:
Xhelal Shaqiri

